LIGJ
Nr.9625, datë 16.10.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8618, DATË 14.6.2000 "PËR TELEKOMUNIKACIONET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 24

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale

Pavarësisht nga neni 22 i ligjit, për qëllime të gjurmimit e parandalimit të veprave penale dhe të procedimit penal, operatori publik i telekomunikacioneve detyrohet të ruajë dhe të administrojë, për një afat dyvjeçar, skedarët e të dhënave për përdoruesit e shërbimeve të tij.

Skedarët e të dhënave për përdoruesit e shërbimeve publike të telekomunikacionit duhet të mbajnë të dhëna që mundësojnë:

a) identifikimin e përdoruesve të shërbimeve publike të telekomunikacionit, duke siguruar marrjen dhe regjistrimin e identitetit të plotë të tyre;

b) identifikimin e tipit të pajisjes fundore, të përdorur gjatë komunikimeve;

c) përcaktimin e datës, orës dhe kohëzgjatjes së komunikimeve.

Këta skedarë duhet t'u vihen në dispozicion, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre.".

Neni 2

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 29

Për përdorimin e shërbimeve telefonike publike, operatori i shërbimeve telefonike publike lidh kontratë me përdoruesit. Çdo kontratë, në zbatim të nenit 24 të ligjit, duhet të përmbajë identitetin e plotë të përdoruesit të shërbimit publik telefonik.

Kontrata tip, që lidhet ndërmjet operatorit dhe përdoruesit, duhet të mbështetet në parimin e barazisë kontraktore të palëve. Ajo hartohet nga operatori dhe miratohet nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve.

Përjashtim bëjnë përdoruesit, që janë abonentë me kartë të parapaguar të operatorëve të shërbimeve publike të telefonisë së lëvizshme. Pavarësisht nga kjo, në zbatim të nenit 24 të ligjit, operatorët e shërbimeve publike të telefonisë së lëvizshme detyrohen të regjistrojnë identitetin e plotë të abonentëve me kartë të parapaguar, përpara aktivizimit të shërbimit.".

Neni 3

Shkronja "c" e pikës 2 të nenit 96 ndryshohet si më poshtë:

"c) shkelen nenet 24, 25, 29 ose 98/1.".

Neni 4

Pas nenit 98 shtohet neni 98/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 98/1

Operatorët publikë të telekomunikacioneve detyrohen të marrin masat dhe të bëjnë regjistrimin e përdoruesve me kontratë pajtimi ose me shërbim të parapaguar, sipas përcaktimeve të nenit 29 të ligjit, deri në

datën 1 korrik 2007.

Operatorët publikë të telekomunikacioneve detyrohen ta ndërpresin këtë shërbim për përdoruesit, të cilët, në përfundim të afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nuk paraqiten pranë tyre dhe nuk përmbushin detyrimet e parashikuara në nenin 29 të këtij ligji.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton formularin me të dhënat, të cilat janë të detyrueshme të jepen nga abonentët, për të mundësuar regjistrimin e tyre sipas këtij neni.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5099, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu